

FTESE**“PËR BASHKPUNIM NDËRMJET AZHBR DHE SUBJEKTEVE
OFERTUESE/FURNITORE TË CILËT JANË TË INTERESUAR PËR TË QENË
PJESË AKTIVE NË REALIZIMIN E INVESTIMEVE TË MBËSHTETURA NGA
AZHBR”**

Të nderuar,

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR) është institucion publik, i krijuar bazuar në ligjin nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, VKM Nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar.

AZHBR synon realizimin e një procesi eficient, transparent e të besueshëm për vlerësimin e çmimeve në funksion të mbështetjes financiare të aplikantëve.

Për sa më lart:

Ju FTOJME të jeni pjesë aktive në realizimin e investimeve të mbështetura financiarisht nga AZHBR i cili do të ndikojë, përveç arritjes së synimeve të AZHBR-së, edhe në shtimin e mundësive tuaja për investime në Shqipëri.

Për arritjen e këtij bashkëpunimi ju duhet të regjistroheni në Sistemin elektronik PRDB (Sistemi i Bazës së të Dhënave për Çmimet e Referencës) duke klikuar në www.prdb.azhbr.gov.al.

Sistemi PRDB është një sistem i hapur 24/7.

Regjistrimi është i thjeshtë, për këtë mund t’ju vij në ndihmë “Manuali i përdorimit të Sistemit PRDB” të cilin e gjeni në web: www.azhbr.gov.al/online-market.

Regjistrimin e subjektit Tuaj në Sistemin PRDB mund ta bëjnë edhe punonjësit e AZHBR-së, për këtë duhet të dërgoni dokumentet me email ose me postë të thjeshtë në adresat zyrtare të AZHBR-së: cmime.reference@azhbr.gov.al; info@azhbr.gov.al; AZHBR, Rruga “Muhamed Gjollesha” Nr. 56, Tiranë.

Për çdo pyetje e paqartësi mund të kontaktoni:

Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural – Rruga “Muhamed Gjollesha”, Nr. 56, Tiranë

Telefon, numri jeshil: 0800 83 83

Email: cmime.reference@azhbr.gov.al

Për informacion të mëtejshme klikoni në web: www.azhbr.gov.al.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Ardita Kuçi